

VENDIM
Nr. 1007, datë 13.11.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 332, DATË 17.3.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS, ELEMENTEVE PËRBËRËSE, MËNYRËS
SË MBAJTJES E AFATIT TË PËRDORIMIT TË DOKUMENTEVE BAZË, QË MBAHEN DHE
LËSHOHEN NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 25, pika 4, 57/6 deri në 57/10 të ligjit nr. 10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Modeli nr. 4 “Procesverbal për ndryshim emri/mbiemri”, në lidhjen nr. 1 që përmendet në shkronjën “ç” të pikës 1 të vendimit nr. 332, datë 17.3.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet sipas modelit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Punëve të Jashtme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama